



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	110/17 116/17			
PËR:	- Zyrtarit e prokurimit të AK-së- Komuna e Deçanit - Parashtruesit të ankesës N.T.P. "ASFALTI" me seli në Pejë - Parashtruesit të ankesës "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan			
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP			
NGA:	Sabrije Bullatovci, Ekspert shqyrtues i prokurimit		<u>Bullatovci</u>	
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar N.T.P. "ASFALTI" me seli në Pejë, me numër protokollit 110/17, dhe ankesën e parashtruar nga OE "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan, me numër protokollit 116/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan" , me nr. të prokurimit: 631/17/277/521, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna e Deçanit.			
Lokacioni:		Prishtinë	Data:	04.05.2017
PËR AKTIVITET				X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR				X
PËR KOMENTE				X
PËR INFORMIMIN TUAJ				X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan"**, me nr. të prokurimit: 631/17/277/521, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Deçanit si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues **"N.T.P. "ASFALTI"** me seli në Pejë, me numër protokollit 110/17 dhe pretendimeve ankimore të OE ankues **"LIKA TRADE" sh.p.k.** me seli në Deçan, me numër protokollit 116/17.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

<i>Boulabani</i>	24.04.2017	25.04.2017	04.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të eksp.	data e fillimit të ekspertizës	data e dorëzimit të raportit

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë 14 prill 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"ASFALTI" sh.p.k.** me seli në Pejë, me nr. të protokollit 110/17, dhe me dt. 20 prill 2017, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE **"LIKA TRADE" sh.p.k.** me seli në Deçan, me nr. të protokollit 116/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan"**, me nr. të prokurimit: 631/17/277/521, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Deçanit. Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: **"ASFALTI" sh.p.k.** me seli në Pejë **"LIKA TRADE" sh.p.k.** me seli në Deçan

Pikat e Ankesës së OE "ASFALTI" sh.p.k. me seli në Pejë:

- Shkelje e nenit 7 të LPP-së, Barazia në trajtim – Jo diskriminim
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së, Kriteret për dhënie të kontratës
- Shkelje e nenit 62 të LPP-së, Anulimi i aktivitetit të prokurimit
- Shkelje e nenit Neni 108/A të LPP-së, Zgjedhja e kontestit preliminar në mes të AK dhe OE.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

- Neni 7, jemi të diskriminuar sepse me dt. 29.03.2017, përmes telefonit zyrtari i prokurimit Xhevdet Ramosaj nga nr. 044/178-837 ne nr. e menaxherit të OE **"Asfalti" sh.p.k.** nr. tel 044/128-025 në orën 9:54, duke na kërkuar dokumentet ATK dhe Certifikatën e Gjykatës, të cilat dokumente kërkohej vetëm për përfituesin, e në këtë rast na jemi OE i cili ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kemi ofruar çmimin me të ulet konform nenit 60 paragrafi 1.1. Në brenda afatit të paraparë ligjorë kemi deponuar dokumentet e kërkuar pran zyrave të prokurimit në Komunën e Deçanit para orës 12:00 të datës 31.03.2017. Këto dokumente siç parasheh ligji kërkohej vetëm pasi që komisioni i vlerësimit të tenderëve e ka përfunduar punën e vlerësimit

dhe ka Rekomanduar OE për dhënie të kontratës, andaj e gjitha sipas ligjit neve si OE i rekomanduar për dhënie të kontratës na kërkohen edhe dokumentet në fjalë. Diskriminim është sepse AK pasi që ne e plotësojmë këtë kriter, atëherë vjen deri te Anulimi i AP.

- Neni 60, shkelje e rende e nenit 60, që është kriter kryesor në këtë AP, ku dihet se tenderi i epet OE që është i përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim të ulët,
- Neni 62 – jeni në kundërshtim të plotë me këtë nen ju si Autoritet Kontraktues sepse një AP mund të anulohet vetëm kur plotësohen këto kushte dhe assesi në këtë arsyetim, sepse ju ne njoftim për Anulim theksoni: Për shkak se me datën 22.03.2017 sipas nenit 39.2 të LPMF-së janë tërhequr nga Buxheti i Komunës së Deçanit tek një OE, nga kodi ekonomik 31230 mjetet e parapara për këtë Aktivitet të Prokurimit, ky fakt nuk qëndron sepse ju edhe pas kësaj date keni vazhduar me vlerësim dhe kur nuk keni arritur qëllimet për të cilat ne nuk jemi në dijeni Zotimi për këtë AP është 490,000.00, ndërsa oferta jonë është: 369,930.00 € (Brenda zotimit).
- Një AP sipas LPP-së mund të anulohet ku plotësohen këto kushte si p.sh. 1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënie të kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozite e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit 1.2. të gjitha tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substancionale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit: 1.3. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikoheshin në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit.
- Kur njoftimi i kontratës është publikuar dhe procedura e prokurimit është anuluar pa dhënie të kontratës publike, autoriteti kontraktues duhet të publikojë njoftimin e anulimit në formën dhe përmbajtjen e informatave përcaktuar nga KRPP-ja, dhe (ii) të përfshijë në të dhënat e prokurimit të kërkuar nga paragrafi 1. I nenit 10 të këtij ligji, një deklaratë me shkrim që parashtron me hollësi arsyet faktet dhe bazën ligjore për anulim.
- Shkelje e nenit 108/A, AK sipas mendimit tone nuk ka analizuar fare ankesën tone dhe si rrjedhojë ka dhënë një përgjigje kundërtënëse, p.sh. Zotimi për projekt: 490.000.00 € oferta jone financiare: 369.930,00, kemi mbetje prej: 120.070,00 €, pra shuma e tërhequr nga thesari për këtë projekt është 100.000,00 €, po të ishte realitet kështu AK do të kishte në dispozicion edhe 20.070,00 € të tjera teprica nga kodi ekonomik 31230.

Kërkojmë që ankesa jonë të aprovohet si e Bazuar dhe Aktiviteti i Prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Pikat e Ankesës së OE "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan

- Shkelje e nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Shkelje e nenit 60 të LPP-së, Kriteret për dhënie të kontratës

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Njoftimin për anulim e kemi pranuar përmes emailit me datën 03.04.2017, i cili përmban të meta të mëdha juridike, gjegjësisht arsyetimi për anulim është ligjërisht i pajustificueshëm.

Një shkelej e LPP-së ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit.

Ky arsyetim është i papranueshëm ligjërisht për faktin se dispozita ligjore e LPP-së theksojmë fare qarte se kur ka një tender të përgjegjshëm mund të procedohet sipas Ligjit.

Ne këtë aktivitet të prokurimit kane marre pjese 7 Operatore ekonomik të cilët kane dorëzuar ofertat e tyre. Autoriteti kontraktues ka bërë pa të drejt anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

- Ne, "Lika Trade" sh.p.k, pas anulimit nga AK-ja kemi kërkuar sipas LPP-se qasje në dokumentacion me datën 06.04.2017, dhe na është mundësuar qasja. Nga qasja në dokumentacion dhe pas analizimit të dokumentacionit të Operatoreve ekonomik kemi arritur në përfundim se ky Aktivitet është anuluar **Pa drejtësisht** nga Autoriteti Kontraktues.
- "Lika Trade" sh.p.k., si operator i përgjegjshëm me çmimin me të ulte, ofron faktet dhe argumentet e marruara nga Qasja në Dokumentacion sipas LPP-se të Operatoreve Ekonomik të papergjegjem në OE "Asfalti" sh.p.k. nuk e ka plotësuar kërkesën Bazike Ligjore dhe të dosjes së Tenderit, pjesa C. Formulari për dorëzimin e tenderit. Nuk e ka plotësuar me siç duhet OE "Asfalti" sh.p.k. në Pjesën C, në formularin e tenderit nuk e ka shkruar Çmimin e Ofruar me shkronja, gjë që është në kundërshtim me LPP-ne.
- OE "Asfalti" sh.p.k., gjithashtu tek pjesa Përshkrimi i çmimeve, përkatësisht paramasa dhe parallogaria, në kolonën e fundit ku kërkohet Vendi Origjinës për materialet e kërkuara. Nuk e ka plotësuar në shumicën e pozicioneve. Gjë që është në kundërshtim me LPP-ne.
- OE "Asfalti" sh.p.k nuk e plotëson piken 9.1 dhe 9.2 të FDT-se, Kontrata dhe reference për shërbime të ngjashme, që kërkohet të jete në vlerë minimale 600.000,00€.
- OE Asfalti sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se Pajiset teknike siç kërkohet të dorëzohet e Noterizuar nga Noteri.
- OE "Asfalti" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Planin i menaxhimit të rrugëve i detajizuar. I cili është dashur të dorëzohet sa me i detajizuar duke u bazuar në rrjetin rrugor të Komunës së Deçanit.
- OE "RSM Cornpani" sh.p.k. tek pjesa II, Përshkrimi i çmimeve, përkatësisht paramasa dhe parallogaria, Nuk e ka plotësuar siç duhet dhe siç kërkohet ndarja e TVSH-se së çmimeve dhe llogaritjen e tyre. Gjë që e bënë të papergjegjshëm dhe që është në kundërshtim me LPP-ne.

- OE "RSM Compani" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Menaxherit të projektit. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e menaxherit të Projektit.
- OE "RSM Compani" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Udhëheqësit të Punishtes. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e Udhëheqësit të Punishtes. Kërkohet në FDT që Diploma e inxhinierit të jetë Kopje e vërtetuar nga Origjinali, ndërsa OE "RSM Compani" sh.p.k, Diplomën e inxhinierit z. Sefedin Shala me numër të diplomës 400 e ka të vërtetuar nga Noteri z. Astrit Bibaj i cili në aktin noterial me numër LRP nr. 876/2017 deklaron se nuk merr përgjegjësi nga përmbajtjen e këtij dokumenti dhe se Diploma është e Vërtetuar nga Kopja. Gjithashtu në CV-in e Udhëheqësit të Punishtes shihet qartë se nuk e ka përvojën e nevojshme dhe të kërkuar në udhëheqjen e projekteve të njëjta (minimumi 2 projekte).
- OE "RSM Compani" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se për Inxhinierit e Gjeodezisë. Kërkohet në FDT që Diploma e inxhinierit të jetë Kopje e vërtetuar nga Origjinali, ndërsa OE "RSM Compani" sh.p.k, Diplomën e inxhinierit z. Eris Ndrukaj me numër të diplomës MP-31 e ka të vërtetuar nga Noteri z. Astrit Bibaj i cili në aktin noterial me numër LRP nr. 1679/2016 deklaron se nuk merr përgjegjësi nga përmbajtjen e këtij dokumenti dhe se Diploma është e Vërtetuar nga Kopja.
- Gjithashtu kjo Diplome është jo Valide pasi që nuk e ka të prezantuar Nostrifikimin e Diplomës të Ministrisë së Arsimit sipas Ligjit.
- OE "RSM Compani" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Plani i menaxhimit të rrugëve I detajizuar. I cili është dashur të dorëzohet sa më i detajizuar duke u bazuar në rrjetin rrugor të Komunës së Deçanit.
- OE "RSM Compani" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Pajisjet dhe mekanizimi për realizimin e punimeve. I cili nuk e ka dorëzuar siç kërkohet Librezat e qarkullimit të automjeteve dhe DUD-at doganor të Noterizuar nga Noteri.
- OE "Arfa" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, (20 punëtorë), nuk ka të prezantuar kontratat për marrëdhënie pune. Gjithashtu mund të shihet qartë nga Lista e pagave të kompanisë se kjo Kompani ka vetëm 19 punëtorë (kontrata të punëtorëve).
- OE "Arfa" sh.p.k tek pjesa II, Përshkrimi i çmimeve, përkatësisht paramasa dhe parallogaria, Nuk e ka plotësuar siç duhet dhe siç kërkohet ndarjen e TVSH-se të çmimeve dhe llogaritjen e tyre. Gjë që e bënë të Papërgjegjshëm dhe që është në kundërshtim me LPP-ne. Po ashtu ka bërë shkarravina në paramasën e dorëzuar. Dhe në kolonën e fundit ku kërkohet Vendi i Origjinës për materialet e kërkuara. Nuk e ka plotësuar pothuajse në të gjitha pozicionet. Gjë që është në kundërshtim me LPP-ne.
- OE "Arfa" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, (20 punëtorë), nuk ka të prezantuar kontratat për marrëdhënie pune. Gjithashtu mund të shihet qartë nga Lista e pagave të kompanisë se kjo Kompani ka vetëm 17 punëtorë.
- OE "Arfa" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Menaxherit të projektit. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e menaxherit të Projektit.
- OE "Arfa" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Udhëheqësit të punishtes. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e Udhëheqësit të punishtes.

- Një (1) Inxhinier diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit

OE-ik duhet te ofroj dëshmi për pajisjet dhe atë si vijon:

- Pesë(5) kamion vetëshkarkues(kiper)
- Cilinder 12t –një copë
- Grejder- një copë
- Buldozher me zingjirë- një copë
- Ngarkues i madh-1 copë
- Ekskavator- dy copë
- Bazë për prodhimin e asfaltit e licencuar , në pronësi, apo marrëveshje për furnizim me asfalt.
- Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr
- Bazë për prodhimin e betonit apo marrëveshje për furnizim me beton(largësia e bazës së betonit mos të jetë mbi 15 km për shkak të cilësisë)
- Deklaratë me shkrim për intervenim në çdo kohë në rast të paraqitjes së kërkesës nga AK
- Plani i menaxhimit të rrugëve

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

- Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015) për punë – të njëjta dëshmuar me kopjet e referencave të ju bashkëngjiten edhe kontratat) në 3 vitet e fundit në vlerën minimale prej 600,000.00 €, duke saktësuar: - punët e përfshira ,shumën e kontratës.
- **Duhet dorëzuar si dëshmi:** Diploma e noterizuar nga origjinali, CV e tij qe dëshmon përvojën në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar.
- Diploma e noterizuar nga origjinali, CV e tyre qe dëshmojnë përvojën e tyre në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar, ndërsa për punëtorët të prezantoj kontratat për marrëdhënie pune apo marrëveshje për angazhim në punë dëshmi lista nga pagesa.
- **Pajisjet - Duhet dorëzuar si dëshmi:** librezat e qarkullimit të automjetit apo dudat doganor për automjete të cili nuk kanë librezë të qarkullimit (të noterizuar nga noteri).Pajisjet duhet të jenë në pronësi apo marrëveshje(qira) për shfrytëzim në **këtë projekt**.
- Deklaratë me shkrim për intervenim në çdo kohë në rast të paraqitjes së kërkesës nga AK-të nënshkruhet.
- Plani i menaxhimit të rrugëve detalizuar.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N. 58):

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	N.N.“ASFALTI”	Bellopoje	369,930.00€
2.	“ENGINEERING”SH.P.K.	Strelle i Ulët	411,260.00€
3.	N.T.SH.N. “ARFA”	Sllup-Deçan	381,230.00€
4.	“RSM COMPANY” SH.P.K.	Prishtinë	373,200.00€
5.	“MIRUSHA COMPANY” SH.P.K.	Klinë	489,500.00€
6.	“LIKA TRADE”	Deçan	382,230.00€
7.	“CONEX GROUP” SH.P.K.	Prishtinë	494,000.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 4 (katër) OE, ku është lexuar shifra e operatorit ekonomik.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 20 mars 2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Shkelzen Shehu, Kryetar i komisionit
- Ajshe Qorraj, Anëtar
- Xhevat Lufaj, Anëtar

Data e fillimit dhe mbarimit të vlerësimi:..... 03.04.2017

Data e njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit (N. 62):.....03.04.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE “ASFALTI” sh.p.k. dhe OE “LIKA TRADE” (N108/A)..... 07/11.04.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni për vlerësimin e ofertave është takuar me dt. 20.03.2017, në ora 10.00, për vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave për projektin: **“Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan”**, me nr. të prokurimit: 631/17/277/521. Dosjen e tenderit e kanë sjellur 7 (shtatë) operator ekonomik, prej tyre dy (2) operator ekonomik në formë elektronike. Ndërsa 5 (pesë) operator ekonomik në kopje fizike. Sipas LPP-së Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, komisioni vazhdoi më tutje me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave dhe konstatoi se OE “Engineering Group” sh.p.k., N.T.SH.N. “ARFA”, “RSM Company” sh.p.k., “Mirusha Company” sh.p.k., “Lika Trade” sh.p.k. dhe “Conex Group” sh.p.k., janë të përgjegjshëm mirëpo kanë ofertuar me çmim më lartë se OE NN “ASFALTI” sh.p.k., për çka edhe bien nga konkurrenca.

Andaj, komisioni i vlerësimit të ofertave rekomandon për nënshkrimin e kontratës për projektin: **“Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan”**, me OE N.N. “ASFALTI” shpk nga Peja. Oferta financiare për këtë projekt është 369, 930.00€. mirëpo ndërkohë pas shpalljes së fituesit të tenderit (Njoftimit për dhënie të kontratës), jemi njoftuar se mjetet financiare të destinuara për këtë projekt janë tërhequr prej buxhetit të Komunës së Deçanit nga ana e Ministrisë së Financave nga kodi ekonomik 31230. Për këtë kemi njoftim me shkrim nga Thesari. Pas këtij njoftimi nga ana e Thesarit për tërheqjen e mjeteve financiare edhe nga projektet tjera si obligime të bartura nga viti paraprak (2016), në konsultim me KRPP-në, u vendos që të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar në dokumentacionin që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit **“Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan”**, me nr. të prokurimit: 631/17/277/521, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 12 muaj, shërbime, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Bazuar në dokumentacionin që ka në shqyrtim, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes shkresës elektronike (emailit), me dt. 23 mars 2017, ka pranuar nga Ministria e Financave-Thesari, Njoftim ku thuhet: ju informoj se OE “Conex Group” ka dorëzuar në Thesar dokumentacionin për pagesë sipas nenit 39.2 të LMFP-së, pasi që Komuna e Deçanit ka shkaktuar vonesë në pagesë. Thesari ka dërguar kërkesë për konfirmim apo kundërshtim të obligimit nga Komuna e Deçanit, ku kemi pranuar përgjigjen për të njëjren lëndë.

Njësia për Monitorim ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka rekomanduar Drejtorin e Përgjithshëm të Thesarit.

Pas aprovimit të pagesës nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, konform kërkesës së nenit 39.2 të LMFP-së, me dt. 22.03.2017, ka bartë shpenzime nga Buxheti i Komunës së Deçanit të OE “Conex Group” në shumë prej 344,309.09€ (pjesa e mbetur nga totali 541,214.58€).

Bazuar në shkresat e lëndës ekspertja shqyrtues sqaron, se në 6 (gjashtë) projekte të parapara për vitin 2017, nga autoriteti kontraktues Komuna e Deçanit janë tërhequr mjetet, në mesin e të cilit është edhe projekt 18015 (Mirëmbajtja e rrugëve lokale nëpër fshatra dhe lidhja e tyre me qytetin) me kod të projektit 45229 dhe kod ekonomik 31230 shuma prej 100,000.00€.

Sqarimi: Nr. 3

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “ASFALTI” sh.p.k. me seli në Pejë, ku thuhet: *Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 62 të LPP-së, sepse një aktivitet i prokurimit mund të anulohet vetëm kur plotësohen këto kushte dhe assesi në këtë arsyetim, sepse ju ne njoftim për Anulim theksoni: Për shkak se me datën 22.03.2017 sipas nenit 39.2 të LPMF-së janë tërhequr nga Buxheti i Komunës së Deçanit tek një OE, nga kodi ekonomik 31230, mjetet e parapara për këtë Aktivitet të Prokurimit, ky fakt nuk qëndron sepse ju edhe pas kësaj date keni vazhduar me vlerësim dhe kur nuk keni arritur qëllimet për të cilat ne nuk jemi në dijeni Zotimi për këtë AP është 490,000.00, ndërsa oferta jonë është: 369,930.00 € (Brenda zotimit)”,* ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se nëse merret për bazë vlera e parashikuar në Deklaratën e Nevoja dhe Disponshmëris së Mjeteve që është 490,000.00€, dhe shuma e tërhequr nga Thesari që është 100,000.00€, për projektin në fjalë, si dhe çmimi i ofruar nga operatori ekonomik ankues që është 369,930.00€, rezulton që çmimi i ofruar nga operatori ekonomik ankues është brenda vlerën e parashikuar të autoritet kontraktues për këtë aktivitetet të prokurimit, edhe nëse janë tërhequr 100,000.00€, nga Departamenti i Thesari.

Ekspertja shqyrtues sqaron se autoritetit kontraktues me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 2 të LPP-së, ku thuhet ndër të tjera thuhet: *“autoriteti kontraktues mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet e dhëna në paragrafin 2.1 dhe 2.2”.*

Sqarimi: Nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “ASFALTI” sh.p.k. me seli në Pejë ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP-së, ekspertja shqyrtues bazuar në shkresat e lëndës sqaron se operatori ekonomik ankues me dt. 06 prill 2017, ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim në autoritetin kontraktues. Ndërsa, autoriteti kontraktues me dt. 07 prill 2017, i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankues, në të cilën parashtrësë autoriteti kontraktues ceke vetëm arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit, ndërsa nuk përgjigjet në pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues.

Ekspertja shqyrtues sqaron se në rastin konkret autoriteti kontraktues, me rastin e rishqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankues nuk ka respektuar nenin 108/A paragrafi 2 të LPP-së, për arsye se në bazë të nenit të lartë cekur dhe nenit 8.1 dhe 8.2 të Rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave, zyrtari përgjegjës i prokurimit është i obliguar të shqyrtoj pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues, dhe të marrë vendim i cili duhet të jetë i arsyetuar lidhur me refuzimin apo miratimin e kërkesës për rishqyrtim, e jo siç ka vepruar në rastin konkret autoriteti kontraktues me përgjigjen e dt. 07 prill 2017.

Sqarimi: Nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “LIKA TRADE” sh.p.k. me seli në Deçan, ku thuhet: *OE “Asfalti” sh.p.k. nuk e ka plotësuar kërkesën Bazike Ligjore dhe të dosjes së Tenderit, pjesa C. Formulari për dorëzimin e tenderit. Nuk e ka plotësuar me siç duhet OE “Asfalti” sh.p.k. në Pjesën C, në formularin e tenderit nuk e ka shkruar Çmimin e Ofruar me shkronja, gjë që është në kundërshtim me LPP-ne*, ekspertja shqyrtues sqaron, OE “Asfalti” sh.p.k. në Formular të tenderit ka dhënë vetëm çmimin me numra, ndërsa nuk e ka dhënë edhe me fjalë, mirëpo me qenë se operatori ekonomik në fjalë ka ofertuar me formë elektronike është dhënë përshkrimi i çmimeve në sistemin elektronike.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “LIKA TRADE” sh.p.k. me seli në Deçan ku thuhet: *“OE “Asfalti” sh.p.k. nuk e plotëson piken 9.1 dhe 9.2 të FDT-se, Kontrata dhe reference për shërbime të ngjashme, që kërkohet të jete në vlerë minimale 600.000,00€”*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues të kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale lidhur me kërkesën e specifikuar në nenin 9.1 të FTD-se, , ka kërkuar si dëshmi dokumentare të ofrohet: *Lista e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit (2013, 2014, 2015) për punë – të njëjta dëshmuar me kopjet e referencave të ju bashkëngjiten edhe kontratat) në 3 vitet e fundit në vlerën minimale prej 600,000.00 €, duke saktësuar: - punët e përfshira ,shumën e kontratës. Ndërsa, OE “Asfalti” sh.p.k , lidhur me kërkesën e lartë cekur si dëshmi ka ofruar listën e punëve të kryera gjatë vitit 2014,2015 dhe 2016, të bashkangjitura kontrata, pranimet teknike dhe referencat.*

Mirëpo në listën e lartë përmendur figuron vetëm një projekt i natyrës së njëjtë me aktivitetin e prokurimit, i kryer nga OE *N.N.T. “ V-Shala &Asfalti” sh.p.k*, bashkangjitur kontrata me Komunën e Pejës në vlerë prej 72,720.00€, si dhe pranimin teknike të punëve, kurse të gjitha projektet tjera janë asfaltim apo renovimi i rrugëve.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “LIKA TRADE” sh.p.k. me seli në Deçan ku thuhet: *“OE Asfalti sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se Pajiset teknike siç kërkohet të dorëzohet e Noterizuar nga Noteri”*, ekspertja shqyrtues sqaron se OE “Asfalti” sh.p.k, ka ofruar si dëshmi lisën e pajisjeve ku deklarohet se të gjitha pajisjet janë prone e tij të noterizuar, bashkangjitur librezat e regjistrimit dhe DUDA Doganore, mirëpo me qenë se operatori ekonomik ka ofertuar në formë elektronike, nuk vërehet se këto dokumente janë të noterizuara.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues “LIKA TRADE” sh.p.k. me seli në Deçan ku thuhet: *OE “Asfalti” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Planin i menaxhimit të rrugëve i detajizuar. I cili është dashur të dorëzohet sa me i detajizuar duke u bazuar në rrjetin rrugor të Komunës së Deçanit*, ekspertja shqyrtues e kualifikon se të pa bazuar për arsye se operatori ekonomik “Asfalti” sh.p.k. ka ofruar si dëshmi Plan të menaxhimit në rrugë gjatë realizimit të punimeve.

Sqarimi: Nr. 6

Ndërsa sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan ku thuhet: "OE "RSM Compani" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Menaxherit të projektit. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e menaxherit të Projektit", ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, të kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuar Një (1) Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (menaxheri i projektit) pesë vite përvojë pune pas diplomimit, dëshmia dokumentare: Diploma e noterizuar nga origjinali, CV e tij që dëshmon përvojën në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar, kurse operatorit ekonomik "RSM Compani" sh.p.k. si dëshmi ka ofruar listën e stafit në dispozicion për projektin "Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan" me nr. të prokurimit 631/17/005/521, ku figuron emri dhe mbiemri Hajredin Ferataj-Inxh, i Ndërtimtarisë- Menaxheri i projektit me 7 vite përvojë punë, bashkangjitur diploma e noterizuar, kontrata e punës e noterizuar dhe CV-in.

Bazuar në atë që u tha me lartë ekspertja shqyrtues pretendimin e operatorit ekonomik ankues e kualifikon si të pa bazuar, për arsye se autoriteti kontraktues në nenin 9.1 dhe 9.2, nuk ka kërkuar nga operatorët ekonomik që të ofrojnë si dëshmi vendimin mbi caktimin e menaxherit të projektit, por Diplomen e noterizuar nga origjinali, CV që dëshmon përvojën në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan ku ndër të tjera thuhet: "OE "RSM Compani" sh.p.k nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Udhëheqësit të Punishtes. Nuk ka bërë fare Vendim mbi caktimin e Udhëheqësit të Punishtes. ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në pikën 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, ka kërkuar: *Inxhinier në punishte dhe mbajtës i databazës. Një (1) Inxhinier diplomuar i ndërtimtarisë ose baqeller dy vite përvojë pune pas diplomimit.* Dëshmia dokumentar: *Diploma e noterizuar nga origjinali, CV e tyre që dëshmojnë përvojën e tyre në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar,* kurse operatorit ekonomik "RSM Compani" sh.p.k. si dëshmi ka ofruar listën e stafit në dispozicion për projektin "Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan" me nr. të prokurimit 631/17/005/521, ku figuron emri dhe mbiemri Sefedin Shala-Inxh, i Ndërtimtarisë- inxhinier i punishtes me 11 vite përvojë punë, bashkangjitur diploma e noterizuar, kontrata e punës e noterizuar dhe CV-in.

Ndërsa sa i përket asaj ku thuhet: "Ne CV-in e Udhëheqësit të Punishtes shihet qarte se nuk e ka përvojën e nevojshme dhe të kërkuar në udhëheqjen e projekteve të njëjta (minimumi 2 projekte)", ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se në CV e z. Sefedin Shala, nuk figuron se ka menaxhuar projektet të njëjta, ashtu siç është kërkuar në FTD në nenin 9.1 dhe 9.2.

Pretendimin e operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan, ku thuhet: "OE "RSM Compani" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Plani i menaxhimit të rrugëve I detajizuar. I cili është dashur të dorëzohet sa më i detajizuar duke u bazuar në rrjetin rrugor të Komunës së Deçanit", ekspertja shqyrtues e kualifikon se të pa bazuar për arsye se operatori ekonomik "RSM Compani" sh.p.k. ka ofruar si dëshmi Plan për menaxhimin e trafikut.

Pretendimin e operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan, ku thuhet: "OE "RSM Compani" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Pajisjet dhe mekanizimi për realizimin e punimeve. I cili nuk e ka dorëzuar siç kërkohet Librezat e qarkullimit të automjeteve dhe DUD-at doganor to Noterizuar nga Noteri", ekspertja shqyrtues e kualifikon se të bazuar për arsye se operatori ekonomik "RSM Compani" sh.p.k. ka ofruar si dëshmi librezat e qarkullimit të automjeteve dhe DUD-at doganore, të cilat nuk janë të noterizuara, ndërsa në FDT, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale në nenin 9.1 dhe 9.2 është kërkuar: Pajisjet - Duhet dorëzuar si dëshmi: librezat e qarkullimit të automjetit apo dudat doganor për automjete të cili nuk kanë librezë të qarkullimit (të noterizuara nga noteri). Pajisjet duhet të jenë në pronësi apo marrëveshje (qira) për shfrytëzim në këtë projekt.

Sqarimi: Nr. 7

Pretendimin e operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan, ku thuhet: "OE "Arfa" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, (20 punëtorë), nuk ka të prezantuar kontratat për marrëdhënie pune. Gjithashtu mund të shihet qarte nga Lista e pagave të kompanisë se kjo Kompani ka vetëm 17 punëtor", ekspertja shqyrtues e kualifikon se të bazuar për arsye se operatori ekonomik "ARFA" sh.p.k. lidhur me kërkesën e specifikuar në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, ku kërkohet: 20 (njëzet) punëtor, të prezantoj kontratat për marrëdhënie pune apo marrëveshje për angazhim në punë dëshmi lista nga pagesa, si dëshmi ka ofruar Listën e pagave për kompaninë për vitin 2016-ATK, ku figurojnë 17 (shtatëmbëdhjetë) punëtor.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan, ku thuhet: OE "Arfa" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se mbi vendimin e caktimit të Menaxherit të projektit dhe vendimin e caktimit të Menaxherit të punishtes, ekspertja shqyrtuesja e kualifikon si të pa bazuar, për arsye se operatori ekonomik "Arfa" sh.p.k. konform kërkesave të specifikuara në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD, si dëshmi ka ofruar listën e personelit kryesor teknik për projektin "Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan" me nr. të prokurimit 631/17/005/521, ku figuron emri dhe mbiemri Afrim Jasiqi-Inxh, i Ndërtimtarisë- Drejtimi Konstruktiv, Menaxher me 16 vite përvojë punë, bashkangjitur diploma e noterizuar, kontrata e punës e noterizuar dhe CV-in, si dhe Aferdita Krasniqi Inxh. e dip. e Ndërtimtarisë- Drejtimi Konstruktiv, Inxhinier e punishtes dhe mbajtjes e databazës, 10 vite përvojë pune.

Bazuar në atë që u tha me lartë ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, nuk ka kërkuar nga operatorët ekonomik që të ofrojnë si dëshmi vendimin mbi caktimin e menaxherit të projektit, por Diplomën e noterizuara nga origjinali, CV që dëshmon përvojën në menaxhimin e projekteve të njëjta (minimumi dy-2) projekte dhe kontrata për marrëdhënie pune e noterizuar .

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues "LIKA TRADE" sh.p.k. me seli në Deçan ku thuhet: " OE "Arfa" sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën e FDT-se, Plani i menaxhimit të rrugëve i detajizuar. I cili është dashur të dorëzohet sa me i detajizuar duke u bazuar në rrjetin rrugor të Komunës së Deçanit nuk e ka dorëzuar fare", ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik "Arfa" ka ofruar si dëshmi përshkrimin e planit të menaxhimit të trafikut gjatë punimeve, ku ka dhënë një përshkrim të shkurtër të planit ku do të zhvillohen punimet.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Bazuar ne sqarimet e cekura në raport, eksperti shqyrtues mendon se autoriteti kontraktues Komuna e Deçanit, në aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja verore e rrugëve në Deçan”**, me nr. të prokurimit: 631/17/277/521, nuk i ka respektuar në tersi dispozitat e LPP-së.

Andaj, i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorëve ekonomik ankues ti aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit te dt. 03 prill 2017, dhe lëndën ta kthej në Ri-vlerësim.